



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA**  
**NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION**

N.SH. "R&B Consult"

Pronar :Ramadan Berisha  
BUSINESS CHANNEL  
OSHP02  
Ulpiana A6, Hyrja 3  
Prishtinë

VENDIMI: LIC/KPM-2012/14  
Ref:1211/1099/KPM/ni

**VENDIM**

*lidhur me kërkesën për ndryshim të pronësisë së OSHP BUSINESS CHANNEL, për ta kaluar te kandidati i propozuar për pronarë "Company 21" Sh.p.k.-RTV21*

**Faktet**

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Më 11 maj 2012, pronari i OSHP BUSINESS CHANNEL ka paraqitur kërkesë në zyrën e KPM-së për ndryshim të pronësisë së licencës nga N.SH. "R&B Consult" dhe kalimin e saj te kandidati për pronarë "21 Company".Sh.p.k.-RTV21.
3. Kandidati i propozuar për pronarë të OSHP BUSINESS CHANNEL, ka deklaruar se përveç pronësisë nuk do të ketë ndryshime tjera, qofte ndryshim të parametrave teknike apo atyre programore.
4. Kandidati i propozuar për pronar të BUSINESS CHANNEL, ka plotësuar të gjitha format e KPM-së, të parapara për ndryshimin e pronësisë, dhe në këtë mënyrë ai ka vepruar sipas të gjitha procedurave të përcaktuara nga KPM, për ndryshim të

pronësisë, duke vepruar kështu në pajtueshmëri të plotë me Kualifikimet për Marrjen e Licencës së KPM-së (Rregullorja CIMC 2009/02).

### Arsyetimi

5. Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin i Pavarur për Media, përcakton se KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediave audiovizuale.
6. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja”*.
7. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së”*.
8. Neni 5.2 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së për OSHP ka siguruar që: *“çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 49% të aksioneve të interesave ose ato që ndikojnë shumë në kontrollin e të Licencuarit do të kërkojnë paraprakisht autorizim me shkrim nga ana e KPM-së”*.
9. Neni 5.3 i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur ajo sigurohet që individit ose organizatës të cilët propozohen që t’u transferohet licenca plotësojnë standardet e KPM-së për t’u dhënë një licencë”*.
10. Prandaj, në pajtim me nenin 5.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, Komisioni i Pavarur për Media, konkludon se kandidatit të propozuar për pronar t’i transferohet licenca, i përmbush standardet e kualifikimit për licencë të KPM-së.
11. Arsyetimin për bartje të pronësisë nga ana e parashtruesit të kërkesës, KPM e pranon si të mjaftueshëm dhe në shërbim të interesit publik për të aprovuar kërkesën për bartje të pronësisë.
14. Kërkesa për ndryshimin e pronësisë është bërë në pajtim të plotë me paragrafin 2.0 të Pjesës së Tretë të Licencës së KPM-së, si dhe në pajtim me nenin 4.8.2 të kushteve dhe termeve të përgjithshme të Licencës së KPM-së për stacion televiziv kabllo dhe për ofruesit e shërbimeve të programeve përmes kabllos.

### Vendim

16. Komisioni i Pavarur për Media, konkludon se kandidati për pronarë të ri të BUSINESS CHANNEL është një kandidat serioz në zhvillimin e Ofruesit të Shërbimeve Programore si dhe i njëjti ka njohuri profesionale dhe menaxheriale.
17. Prandaj, KPM merr vendim që pronësia e OSHP BUSINESS CHANNEL të ndryshohet dhe të kalohet nga N.SH. "R&B Consult" në "Company 21" Sh.p.k.-RTV21.

### Lëshimi i Vendimit

18. Këtë vendim e lëshon Komisioni.

  
\_\_\_\_\_  
Shëfki Ukaj  
Kryetar  
Komisioni i Pavarur për Media



15.11.2012  
datë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA  
NEZAVISNA KOMISJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

Rizvan Rexhaj  
Pronar  
KNN  
OSHP037  
Zona Inustriale,  
Objekti i Univeristetit AAB Nr.4  
Prishtinë

VENDIMI: LIC/KPM-2012/16  
Ref:1211/1101/KPM/ni

**VENDIM**

*në lidhje me kërkesën e ofruesit të shërbimeve programore KNN për ndryshimin e emrit në ART*

**Faktet**

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Ofruesi i Shërbimeve Programore (OSHP) KNN, me seli në Prishtinë, është pajisur me licencë të KPM me 27 tetor 2010, për të vepruar si OSHP.
3. KPM, me datën 25 nëntor 2011, ka pranuar kërkesën nga pronari i KNN për ndryshimin e emrit nga KNN në ART.

**Arsyetim**

4. Kërkesa për ndryshimin e emrit të OSHP KNN në ART është bërë për shkak se, emri i propozuar është më i përshtatshëm, pasi që i njëjti është akronim i Universitetit AAB.
5. Kërkesa e pronarit të KNN për ndryshim të emrit të këtij OSHP, nuk paraqet asnjë ndryshim tjetër në Pakon e Licencës së KPM-së për këtë OSHP.


6. Emri i propozuar ART për t'u identifikuar në të ardhmen si OSHP në Republikën e Kosovës, nuk është i ngjashëm me asnjë nga emrat e subjekteve transmetuese të licencuara nga KPM dhe që operojnë në Republikën e Kosovës.

### Vendim

7. Komisioni i Pavarur për Media, konkludon që ndryshimi i emrit të OSHP KNN në ART nuk paraqet ndryshime në pronësi apo në skemën e propozuar programore.
8. Komisioni i Pavarur për Media, merr vendim që OSHP KNN t'i lejohej ndryshimi i emrit në ART.

### Lëshimi i Vendimit

9. Këtë vendim e lëshon Komisioni.



Shefki Ukaj  
Kryetar  
Komisioni i Pavarur për Media



15.11.2012

datë